


Niart SHPK
Milazim Gashi
Drejtör
Kryshec
Pejë

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2022/3 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Niart SHPK (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është autoriteti i vetëm në territorin e Republikës së Kosovës përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe caktimin e resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit, dhënien e licencave dhe mbledhjen e taksave për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese. KPM në bazë të Ligjit të KPM-së është organ i pavarur rregullativ në fushën e transmetimit i cili licencën transmetuesit publik dhe privat. Autoriteti i KPM-së shtrihet në fushën e licencimit dhe rregullimit të televizioneve, radiove, operatorëve të shpërndarjes, si dhe Ofruesve të Shërbimeve Programore.
2. KPM ka pranuar Ankesë nga Operatori i shpërndarjes Artmotion (Pala ankuese) me datën 30 nëntor 2021 kundër Palës përgjegjëse, me pretendimin se është duke i ritransmetuar kanalet Klan Kosova, RTV Dukagjini, Kanal 10, Arena Sport 1-4, Arena Premium, Discovery Channel dhe TV kanalet turke.
3. KPM me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese ka realizuar vizitë në teren me datën 16 dhjetor 2021, ku edhe është kuptuar se Pala përgjegjëse ka një listë të kanaleve, për transmetimin e të cilave, sipas tyre, ka marrëveshje me Operatorin e shpërndarjes Telkos. Mirëpo, gjatë monitorimit të katalogut të kanaleve nuk është gjetur asnjë element që e identifikon atë me Telkos. Kështu që, Palës përgjegjëse i është dorëzuar Njoftimi për shkelje për transmetim ilegal dhe kërkesa për ndërprerje të menjëhershme të operimit ilegal pasi që vazhdimi i transmetimit pa licencë do të rezultojë me konfiskimin e aparaturave për transmetim.
4. KPM ka komunikuar me Telkos dhe me datën 8 shkurt 2022 ka marrë e-mail nga Telkos, i cili ka njoftuar se e ka shkëputur marrëveshjen me Palën përgjegjëse për transmetim të kanaleve.



5. KPM ka realizuar edhe një vizitë në teren me datën 25 shkurt 2022, ku është vërtetuar edhe një herë se Pala përgjegjëse nuk e ka ndërprerë transmetimin ilegal dhe se nuk ka filluar procedurat e licencimit.

Analiza ligjore

6. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura, ka gjetur se Pala përgjegjëse është duke vepruar në kundërshtim me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili përcakton se:

“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja.”


7. KPM e ka njoftuar Palën përgjegjëse se është duke transmetuar ilegalisht me shkresën e dërguar dhe e ka paralajmëruar se nëse vazhdon transmetimin do t’i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim, duke u bazuar në nenin 30, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:

“Kushdo që operon pa leje transmetuese valide i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa.”

8. Nga provat e siguruar nga KPM vërehet se Pala përgjegjëse transmeton një listë të kanaleve dhe se nuk ka ndërmarrë hapa për licencim në Komisionin e Pavarur të Mediave për të vepruar në pajtim me Ligjin Nr.04/L-44.
9. KPM vlerëson se Palës përgjegjëse i është dhënë mundësia për t’u licencuar, ashtu siç përcaktohet me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44. Mirëpo, Pala përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtim me Ligjin Nr.04/L-44.
10. Prandaj, Zyra Ekzekutive e KPM-së, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se Pala përgjegjëse është duke vepruar në kundërshtim me nenin 21, paragrafi 1, të Ligjit Nr.04/L-44.

Vendim

11. KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura autorizon Zyrën Ekzekutive të KPM-së që në bashkëpunim me organet kompetente për zbatimin e ligjit në Kosovë, siç përcaktohet në nenin 30, paragrafi 8, të Ligjit Nr.04/L-44, Palës përgjegjëset’i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim siç përcaktohet në nenin 30, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së.


Xhevat Latifi
Kryetar



04.03.2022
Datë